



SINDIKATA E POLICISË SË KO SINDIKAT POLICIJE KOSOVA KOSOVO POLICE UNION	
Nr./Br./No. 21/026/22	Nr.faq./Br.str./No.pg. 6
Data/Datum/Date 25.11.2022	
PRISHTINË-PRISHTINA-PRISHTINE	

KONTRATË PËR SHËRBIME

Kjo Kontratë për shërbime është lidhur në Prishtinë më 25.11.2022 ndërmjet palëve kontraktuese:

Sindikata e Policisë së Kosovës me numër fiskal 600595899, me adresë në Rr. Luan Haradinaj, Prishtinë, e përfaqësuar nga Kryetari z. Imer Zeqiri me numër personal të identifikimit 101352056.

(në tekstin e mëtejshëm referuar si “Sindikata e Policisë së Kosovës” dhe/ose “Klienti”), dhe

AVICENA-KS SH.P.K. e regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë me numër Unik Identifikues 810004755, me adresë në Rr. Hyrje V A5 - L01, Rruga Radovan Zogovic, Prishtinë, përfaqësuar nga z. . Amar Shuki, Drejtor Menaxhues.

(në tekstin e mëtejshëm referuar si “Kontraktori”)

Palët janë dakorduar si më poshtë:

Neni 1 - Objekti i Kontratës

Objekti i kësaj kontrate është kryerja e analizave mjekësore laboratorike për anëtarët e Sindikatës së Policisë së Kosovës dhe të gjithë pjesëtarët e Policisë së Kosovës, në përputhje të plotë me kërkesën e klientit dhe Ofertën e Kontraktorit.

Neni 2 – Kohëzgjatja e kontratës

Kontrata hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit nga të dyja palët dhe vazhdon të jetë në fuqi deri më datë 25.11.2023.

Neni 3 - Çmimi i Kontratës

- Për të gjithë anëtarët e Sindikatës së Policisë dhe të gjithë pjesëtarët e Policisë së Kosovës, çmimi për kryerjen e analizave rutinore biokimike është me zbritje 50%, ndërsa në të gjitha llojet tjera të analizave është zbritje prej 30%, nga çmimi i rregullt në ditën që merret shërbimi.

- Për të gjithë familjarët e policëve të rënë në detyrë, çmimi për kryerjen e analizave rutinore biokimike është me zbritje 50%, ndërsa në të gjitha llojet tjera të analizave është zbritje prej 30%, nga çmimi i rregullt në ditën që merret shërbimi.

- Për të gjithë familjarët e ngushtë të të gjithë pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, çmimi për kryerjen e analizave laboratorike është me zbritje 20% nga çmimi i rregullt në ditën që merret shërbimi.

Neni 4 - Obligimet e Kontraktorit

1. Kontraktori do të kryejë punët sipas protokolleve mjekësore të aplikueshme në këtë fushë.
2. Kontraktori duhet t'i përmbahet dhe të jetë në përputhje me të gjitha aktet e brendshme të aplikueshme të klientit, të cilat i janë bërë të njohura Kontraktorit nga ana e Klientit.
3. Kontraktori bie dakord të kryjë vetëm punët të cilat Klienti paraprakisht i ka miratuar me shkrim.

Neni 5 - Garancia

1. Kontraktori garanton profesionalizimin dhe respektimin e protokolleve mjekësore të aplikueshme.
2. Kontraktori garanton saktësinë e të dhënave të analizave laboratorike.

Neni 6 - Ndërprerja e Kontratës

1. Palët kontraktuese bien dakord që secila palë kontraktuese mund ta ndërpres këtë kontratë duke i dhënë palës tjetër një periudhë njoftimi prej 30 (tridhjetë) ditësh.
2. Secila palë mund të ndërpres kontratën pa dhënë ndonjë periudhë të njoftimit në rast se pala tjetër pushon veprimtarinë afariste ose bëhet e paafte të paguajë ose i nënshtrohet falimentimit ose ndonjë procedure tjetër të likuidimit.
3. Ndërprerja e kontratës do të jepet me shkrim dhe do të dorëzohet me postë ose email.

Neni 7 – Forca madhore

1. Asnjëra palë nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë vonesë në kryerjen e detyrimeve të saj sipas kontratës nëse vonesa e tillë është shkaktuar nga forca madhore. Pala që nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e saj për shkak të forcës madhore, menjëherë do të njoftojë Palën tjetër për një ngjarje të tillë, ku njoftimi i mësipërm do të përfshijë arsyet e hollësishme.
2. Forca madhore konsiderohet një ngjarje e paparashikuar dhe e papritur e cila nuk varet nga vullneti i palëve kontraktuese.

Neni 8 - Konfidencialiteti

Të gjitha dokumentet në lidhje me lëndën e kësaj kontrate do të konsiderohen konfidenciale. Çdo person, punonjës apo punëtorët tjerë të cilët kanë qasje në këto informata konfidenciale nuk do të zbulojnë këto informata ndonjë palë të tretë pa lejen shprehimore me shkrim të personit të autorizuar, përveç për personat që kanë nevojë të informohen me sipas detyrës zyrtare ose personat të cilët janë të autorizuar për këtë arsye sipas legjislacionit të zbatueshëm.

Neni 9 - Klauzola Kundër Korrupsionit

1. Palët kontraktuese konfirmojnë se asnjëra prej tyre, si dhe asnjë person tjetër për dhe në emër të tyre, në asnjë moment përpara lidhjes së Marrëveshjes, në momentin e nënshkrimit ose në fazën e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje, si dhe ndonjë marrëveshje tjetër të lidhur, nuk ka ofruar dhe nuk do t'i ofrojë, ose premtojë ndonjë përfitim të paligjshëm palës tjetër kontraktuese, punonjësit të saj, zyrtarit, anëtarit të organit drejtues ose mbikëqyrës, përfaqësuesit, agjentit ose ndonjë personi të tretë për:
 - përfitimin e një marrëveshjeje, ose
 - lidhjen e marrëveshjes me kushte më të favorshme, ose
 - mos mbikëqyrjen e duhur mbi ekzekutimin e detyrimeve kontraktuale, ose
 - kryerja e ndonjë veprimi ose mosveprimi tjetër nëpërmjet të cilit pala kontraktuese ose një person i tretë mund të pësojë dëme të paligjshme ose një palë kontraktuese, punonjësi i saj, zyrtari, anëtari i organit drejtues ose mbikëqyrës, përfaqësuesi, agjenti ose ndonjë person i tretë mund të përfitojë përfitim të paligjshëm.
2. Në rast të shkeljes së kësaj klauzole, Marrëveshja e lidhur konsiderohet e pavlefshme dhe nuk përbën detyrime për Palët kontraktuese.

Neni 10 - Siguria në punë

Kontraktori do të kujdeset vetë për sigurinë e tij në punë. Klienti nuk do të ketë ndonjë detyrim në lidhje me lëndimin dhe pagesën e ndonjë kompensimi për një aksident ose lëndim të punonjësit të Kontraktorit, përveç në rast kur aksidenti ka ndodhur vetëm me fajin e Klientit.

Neni 11 - Ligji qeverisës dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kjo kontratë i nënshtrohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e zbatueshme të Kosovës.
2. Çdo mosmarrëveshje do të jetë subjekt shqyrtimi nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Neni 12 - Njoftimet dhe kontaktet

1. Të gjitha njoftimet ndërmjet palëve do të jenë me shkrim, dhe do të dërgohen me postë ose me email.
2. Palët kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën me shkrim për çdo zëvendësim të adresave, brenda tri (3) ditëve nga çdo zëvendësim i tillë.

Neni 13 - Dispozitat përfundimtare

1. Kontrata përfaqëson të gjithë mirëkuptimin dhe kontratën midis Palëve si pas lëndës së saj, dhe bashkon të gjitha diskutimet dhe negociatat paraprake mes tyre. Kontrata mund të ndryshohet vetëm me shkrim.
2. Kjo kontratë nuk mund të transferohet pa miratimin paraprak me shkrim të palës tjetër. Çdo përpjekje për të transferuar ndonjë të drejtë, detyrim apo angazhim që rrjedh nga marrëveshja pa miratimin paraprak të Klientit do të jetë e pavlefshme, përveç ndonjë ndryshimi që është pasojë e ndryshimeve statutore të Klientit ose Kontraktorit.
3. Klienti dhe Kontraktori bien dakord se çdo ndryshim apo plotësim i kontratës do të jetë i vlefshëm vetëm nëse është bërë në formë të një shtojce të shkruar të bashkangjitur kontratës.

4. Në rast se ndonjë dispozitë e kësaj kontrate nuk është në përputhje me legjislacionin dhe ligjet në fuqi, pavlefshmëria e tillë nuk do të ndikojë në dispozitat e mbetura të kësaj kontrate. Palët do të arrijnë një kontratë për dispozitat e reja që do të jenë në përputhje me legjislacionin dhe ligjet në fuqi dhe të cilat do të ndjekin qëllimin e kësaj kontrate.
5. Kontrata hyn në fuqi kur ajo është e nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i secilës palë.
6. Kjo kontrata është përpiluar në 2 (dy) kopje origjinale, ku secila palë do të marr nga 1 (një) kopje.

NËNSHKRIMET E PALËVE

AVICENA – KS SH.P.K.


z. Amar Shuki, Drejtor Menaxhues



Sindikata e Policisë së Kosovës


z. Imer Zeqiri, Kryetar



ANEKSI 1

- Analizat rutinore biokimike me 50% zbritje

Nr.	Analiza:
1	Hemogram
2	Analiza e urines
3	Crp
4	Eritrosedimenti ESR
5	Alp
6	Alat
7	Asat
8	GGT
9	LDH
10	Bilirubine totale
11	Bilirubine direkte
12	Amylase
13	Lipase
14	CK
15	CK-MB
16	D-dimer
17	Acid urik
18	Glukoza
19	HbA1c
20	Trigliceride
21	Cholesterol
22	Hdl
23	Ldl
24	Calcium
25	Natrium
26	Magnezium
27	Kalium
28	Fosfori
29	UIBC
30	Iron
31	Aso
32	IgG
33	IgM
34	IgA
35	Fosfataza acidike
36	RF-fak.reumatik
37	Urea
38	Creatinina
39	Total proteins

40	Albumine
41	Free T3
42	Free T4
43	TSH

NËNSHKRIMET E PALËVE

AVICENA – KS SH.P.K.



z. Amar Shuki, Drejtor Menaxhues

Sindikata e Policisë së Kosovës



z. Imër Zeqiri, Kryetar